



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 3440 prot.

Shkodër, më 07.11.2022

V E N D I M

Nr. 224, datë 07.11.2022

**"Për një ndryshim në Rregulloren e doktoratës në "Gjuhë shqipe"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa "d"; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa "r", Rregullores së doktoratës në "Gjuhë shqipe", Senati akademik me propozim të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022

**Vendosi:**

1. Të miratojë ndryshimin e Rregullores së Doktoratës në "Gjuhë shqipe", neni 37 "Të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve", pika 1, duke shtuar si nënpikë (Doktorantët kanë këto të drejta) :

- "Të angazhohen në mësimdhënie në programet e ciklit të parë e të dytë, si dhe në aktivitete të ndryshme kërkimore të institucionit të lidhura me fushën specifike të programit të doktoraturës, duke u mbështetur financiarisht nga USH".

3. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Qendra e Studimeve Albanologjike për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARË  
Prof. dr. Suzana GOLEMI